



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Shtator 2021

Nr. 452

VENDIM

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në datën 21.9.2021, në përmbushje të vendimit nr. 103, datë 14.7.2021, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi riçeli hetimin administrativ të çështjes që u përket:

Kërkues: Organizata “Qëndresa Qytetare”

Ndaj: Zj. Gerta Duraku
Zyrës Vendore Arsimore, Kukës
Drejtorit të shkollës së mesme “Shëmri”, Kukës
Partisë Socialiste të Shqipërisë

Objekti i ankimit: Për rishqyrtimin administrativ të shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, në lidhje me zhvillimin e veprimtarisë me qëllime zgjedhore në ambientet e shkollës së mesme “Shëmri”, Kukës

Baza ligjore: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, dhe neni 171, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

I. Rrethanat e faktit

- Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 17.03.2021, nëpërmjet e-mail është raportuar një denoncim nga Organizata “Qëndresa Qytetare”, me pretendimin se në ambientet e shkollës së mesme “Shëmri”, Kukës, është bërë prezantim i kandidatës për deputete të subjektit zgjedhor



Partia Socialiste e Shqipërisë, zj. Gerta Duraku, në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3 të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

- Në cilësinë e provës, Organizata “Qëndresa Qytetare”, ka vendosur në dispozicion një link të rrjetit social facebook, në të cilin sipas saj, janë shpërndarë foto nga takimi objekt denoncimi.
- Link: <https://ëëë.facebook.com/1012875545404246/posts/5487957724562650/>
- Nëpërmjet shkresës nr. 3405 prot., datë 7.4.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka kërkuar informacion sqarues në lidhje me zhvillimin e këtij aktiviteti Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, e cila në përgjigje të saj nëpërmjet shkresës nr. 343/1 prot., datë 17.4.2021, bën me dije se prezantimi i kandidatës është zhvilluar në ambientet e jashte të shkollës, pas orës 16:00, sikurse dhe për kandidatë të forcave të tjera politike.
- Nëpërmjet shkresë 4517 prot., datë 5.5.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është adresuar sërish Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, për t’i vënë në dispozicion fotot e aktivitetit të zj. Gerta Duraku, paraqitur në cilësinë e provës nga Organizata “Qëndresa Qytetare”, duke i kërkuar sqarim nëse këto foto, në çmimin e tyre, janë në ambientet e shkollës së mesme “Shëmri”, Kukës. Nëpërmjet shkresës nr. 343/3 prot., datë 19.5.2021 Zyra Vendore Arsimore, Kukës bën me dije se fotot i përkasin ambientit privat të z. Avdyl Brija. Bashkëlidhur konfirmimi i administratorit të njësisë administrative Malzi.
- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmoi se të dhënat e paraqitura nga denoncuesi Organizata “Qëndresa Qytetare” përbënin indicie të besueshme për fillimin e procedurës administrative.
- Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në çmim të fakteve dhe provave të disponuara nga palët në shqyrtim administrativ, nëpërmjet vendimit nr. 423 datë 5.7.2021, vendosi përfundimin e shqyrtimit administrativ ndaj kandidatës për deputete zj. Gerta Duraku dhe Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, pasi nuk rezultoi e provuar se ky aktivitet i zhvilluar me prezencën e zj. Gerta Duraku *“përbën vënie në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje të burimeve të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor; apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia, ku me “burime” kuptohet aset i paluajtshëm, i parashikuar në nenin 142 të Kodit Civil, sipas përcaktimeve të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator”*.
- Më datë 12.07.2021 Organizata “Qëndresa Qytetare”, ka paraqitur kërkesën ankimore nr. 59, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) me objekt “Kundërshtimi i vendimit nr. 423, datë 05.07.2021” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.
- Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr. 103 datë 14.07.2021 vendosi:



1. Shfuqizimin e vendimit nr. 423, datë 5.7.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Riçeljen e hetimit administrativ të plotë e të gjithëanshëm nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe Kodin e Procedurave Administrative duke garantuar të drejtat e palës në procesin administrativ kandidates për deputete, Drejtorisë së Zyrës Vendore Arsimore Kukës dhe drejtorit të shkollës së mesme “Shëmri”, Kukës.

II. Riçelja e hetimit administrativ

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në respektim të vendimit të KAS nr. 103, datë 14.07.2021, ditën e premte, më datë 17.09.2021, ora 12:00, në përputhje me përcaktimet e nenit 47 dhe 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, riçeli hetimin administrativ të plotë e të gjithëanshëm për të garantuar të drejtat e palëve në proces administrativ, duke zhvilluar një seancë dëgjimore, në të cilën u thirrën: Organizata “Qëndresa Qytetare”, zj. Gerta Duraku, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, drejtori i Zyrës Vendore Arsimore Kukës, Drejtori i, shkollës së mesme “Shëmri”, Kukës, si dhe subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”
- Në seancën dëgjimore mori pjesë përfaqësuesi i Organizatës “Qëndresa Qytetare” si dhe z. Agim Muslia, drejtor i Shkollës së mesme “Shëmri”, Kukës.
Drejtor i Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, nëpërmjet shkresës nr. 343/4 prot., datë 17.09.2021, njofton pamundësinë e paraqitjes në seancën dëgjimore të datës 17.09.2021, për arsye shëndetësore.
Palët e tjera të thirrura në seancë dëgjimore nuk u paraqitën.
- Përfaqësuesi ligjor i Organizatës “Qëndresa Qytetare”, rikonfirmoi pretendimet e tij për përdorimin e mjedisit arsimor shkolla e mesme “Shëmri”, Kukës, për aktivitet të fushatës elektorale nga kandidati për deputet zj. Gerta Duraku, i subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.
- Në shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore tij, drejtori i shkollës së mesme “Shëmri”, Kukës, deklaroi se: nuk është zhvilluar mbledhje në ambientet e brendshme të shkollës, por prezantimi i kandidates është bërë në ambientet e jashtme të saj, në oborrin e shkollës, sikurse është bërë dhe për kandidatë të tjerë të forcave të tjera politike.

III. Analiza e fakteve dhe provave



- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku të paraqitura nga denoncuesi Organizata “Qendresa Qytetare”, çmon sipas bindjes së tij se, aktiviteti i kandidates për deputete zj. Gerta Duraku, në ambientet e administratës arsimore, përbën shkelje sipas parashikimeve të nenit 3, pika 1.3, shkronja c, të vendimit nr. 09 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet së cilit parashikohet se *“veprimtari të ndaluara”, janë ato veprimtari që përfshijnë vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142 të ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore që janë në pronësi apo administrim organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njëjsteve të vetëqeverisjes vendore, apo çfarë do lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikqyrës apo organit administrative të entit”*.
- Përsa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se:
 1. Duke qenë se asnjë nga palët e interesuara nuk depozitoi ndonjë provë shkresore që vërtetonte faktin se, Zyra Vendore Arsimore Kukës, ka dhënë leje/miratim për zhvillimin e këtij aktiviteti elektoral në ambientet e shkollës së mesme “Shëmri”, Kukës, nuk mund të merret sanksion administrativ ndaj saj.
 2. Veprimet e Drejtorit të Shkollës së Mesme “Shëmri”, Kukës, nëpërmjet së cilave ka lejuar kryerjen e një aktiviteti elektoral ,në ambientet e shkollës së Mesme “Shëmri”, Kukës, (oborrin e shkollës), ka shkelur nenin 91, të ligjit nr. 10019 , datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 3, pika 1.3, shkronja c, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të nxjerrë në zbatim të tij.
- Në këto kushte, sipas përcaktimeve të nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, *“Shkelja e dispozitave të këtij kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga personat e ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale dënohet me gjobë nga 3.000 deri në 90.000 lekë”*.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, e pika 2, nenin 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,



V E N D O S:

1. Të dënojë me gjobë Drejtorin e Shkollës së Mesme “Shëmri”, Kukës, në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë.
2. Ky vendim përbën titull ekzekutiv.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 21 Shtator 2021
Nr. 452

Riçelje e hetimit administrativ ndaj kërkesës ankimore nr. 59 datë 12.7.2021 depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve